



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

KRYETARI I KOMUNËS

01. nr. 031-8189, më 13-01-2016

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), të nenit 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5, të nenit 4 të Ligjit nr. 04/L - 050 për deklarim, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Komunës, në cilësinë e organit më të lartë administrativ dhe punëdhënës, më 01.12.2015, nxjerr këtë

V E N D I M

I.

Zijadin Gashi, shef në zyrën e Kuvendit, CAKTOHET koordinator i punëve me Agjencinë Kundër Korrupsion.

II.

Detyrat e zyrtarit kontaktues, janë si në vijim:

1. Përcjell listën me emrat e zyrtarëve të lartë politik dhe njofton Agjencinë për ndryshimet në listë brenda afatit pesëmbëdhjetë (15) ditor;
2. Njofton zyrtarët e lartë për deklarim të pasurisë;
3. Regjistron dhuratat e pranuar nga personat zyrtar në regjistrin e institucionit dhe dorëzon kopjen e regjistrit tek Agjencia, deri më 31 mars të secilit vit kalendarik.

III.

Me këtë vendim, anulohet vendimi paraprak i dt. 18.02.2014.

IV.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes së tij.

I DORËZOHET:

- Të emëruarit,
- Në dosje dhe
- Qendrës për shërbime me qytetar.

